




20 Qershor 2025

NJOFTIM

PËR REALIZIMIN E TRAJNIMIT ME TEMË "PLATFORMA E BASHKËPUNIMIT "administrata.al""

Në datat 16 dhe 19 qershor 2025, u zhvillua në ambjentet e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, workshopi mbi Platformën e Bashkëpunimit, i mundësuar nga projekti "Mbështetja e Reformës së Administratës Publike në Nivel Vendor në Shqipëri", financuar nga Republika Federale Gjermane. Platforma e bashkëpunimit "administrata.al" shërben si burim informacioni apo mjet kontrolli për Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil dhe DAP-in, për realizimin e funksioneve të tyre lidhur me zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil.



Platforma e bashkëpunimit është një sistem i centralizuar, i cili synon të modernizojë proceset e menaxhimit të burimeve njerëzore (HRM) në administratën publike në Shqipëri.

Në këtë workshop morën pjesë nëpunës të stafit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil si dhe përfaqësues të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Modulet që u trajtuan ishin: platforma e bashkëpunimit, identifikimi dhe aksesimi i përdoruesve, raportimi mujor, përshkrimi i vendeve të punës, vlerësimi i performancës, menaxhimi i lejeve, masat disiplinore, lirimet dhe pezullimet si dhe proceset gjyqësore.